

**PROJEKT-REZOLUTË**  
**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË STRUKTURËS SË POSAÇME KUNDËR**  
**KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR**  
**PËR VITIN 2022**

Në Kuvendin e Shqipërisë është paraqitur raporti “Mbi veprimtarinë e Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar gjatë vitit 2022” bazuar në përcaktimet e neneve 104 dhe 105 të Ligjit Nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”.

Në raportin “Mbi veprimtarinë e Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar gjatë vitit 2022” janë paraqitur treguesit e punës, gjendja e kriminalitetit sipas juridiksionit përkatës dhe veprimtaria e realizuar në zbatim të Ligjit Nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

**Kuvendi i Shqipërisë për veprimtarinë e Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar gjatë vitit 2022:**

*Konsideron* si të një rëndësie të veçantë, rolin e Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar në ushtrimin e ndjekjes penale, hetimin, përfaqësimin e akuzës në emër të shtetit para Gjykatës së Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Gjykatës së Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Gjykatës së Lartë.

*Vlerëson* ngarkesën që Prokuroria e Posaçme dhe BKH-ja kanë mbajtur gjatë vitit 2022, rezultatet pozitive të evidentuara në luftën kundër krimit të organizuar, si dhe hetimin e një sërë çështjeve të cilat lidhen me korrupsionin.

*Vlerëson* si inkurajuese, rezultatet pozitive në luftën kundër krimit organizuar e shoqëruar me rritjen e bashkëpunimit të homologëve ndërkombëtarë të SPAK-u.

**Kuvendi i Shqipërisë për veprimtarinë e Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për vitin 2022 konstaton se:**

- Prokuroria e Posaçme dhe Byroja Kombëtare e Hetimit kanë pasur mbështetje aktive me burime buxhetore e njerëzore, në trajtimin me paga dhe përfitime të tjera financiare shtesë dhe me instrumente ligjore shtesë në funksion të rritjes së efikasitetit të tyre dhe çmon se kjo mbështetje, ka rritur pritshmërinë e taksapaguesve shqiptarë për një ritëm më të shpejtë në rezultate më domethënëse në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit në nivelet e larta në veçanti, pavarësisht kohës dhe personave të përfshira në to, si kusht thelbësor për të forcuar më tej besimin e publikut te drejtësia.
- Prokuroria e Posaçme dhe Byroja Kombëtare e Hetimit ka kontribuar në plotësimin e elementëve të planit të veprimit ICRG/FATF, duke bërë që Shqipëria të adresojë plotësisht pikën IO.8.
- Është rritur vlera e asetëve të konfiskuara, dhe numri i çështjeve të cilat janë përfunduar me vendime dënimi në fushën e pastrimit të parave, si dhe konfiskimet e asetëve kriminale në procesin penal.
- Është plotësuar organika me 60 hetues të Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe nga pikëpamja organizative, duke bërë që struktura e SPAK-ut të vijë drejt konsolidimit, ndërsa plotësimi me prokurorë dhe staf të specializuar është ende në proces.

- Ka nisur krijimi i një qasjeje strategjike në komunikimin me publikun për të krijuar dhe siguruar besimin e tij në organet e reja të drejtësisë.
- Po vlerësohet në vazhdim, krijimi i një sistemi për menaxhimin e çështjeve, e cila do të japë më shumë mundësi për të pasur transparencë dhe pavarësi në trajtimin e çështjeve.

**Kuvendi i Shqipërisë i rekomandon Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, për vitin 2023, në përmbushje të detyrave të ngarkuara me ligj, të angazhohet veçanërisht dhe në këto drejtime:**

1. Të rrisë përdorimin e teknikave të hetimit dhe numrin e hetimeve proaktive në çështjet e korrupsionit të zyrtarëve të lartë, përfshirë dhe ish magjistratë, dhe krimit të organizuar me prioritet çështjet me interes të veçantë publik;
2. Të rrisë numrin e hetimeve financiare dhe pasurore si dhe sekuestrimin dhe konfiskimin e asetëve kriminale, që rezultojnë nga veprat penale të kryera në kuadrin e korrupsionit dhe krimit të organizuar brenda dhe jashtë vendit;
3. Të forcojë bashkëpunimin me Inspektorin e Lartë të drejtësisë dhe të vlerësojë referimet nga publiku, media dhe shoqëria civile lidhur me praktikat e mundshme korruptive në radhët e gjyqtarëve, prokurorëve dhe OPGJ-ve të të gjitha niveleve si kusht për të garantuar përgjegjshmërinë dhe integritetin profesional dhe etik në sistemin e drejtësisë;
4. Të vijojë puna për ngritjen e sistemit të administrimit të çështjeve, ku të vlerësohet dhe përfshirja e krijimit të “track rekordit” për procedimet penale të korrupsionit në nivele të larta, kusht i vendosur edhe nga Komisioni Evropian;
5. Të përmbyllë procesin e plotësimit të vendeve vakante në SPAK dhe të vijojë me nxjerrjen e akteve nënligjore të cilat përmirësojnë efikasitetin e tij;
6. Të realizojë ndërtimin i një kornizë strategjike institucionale, që të përmbajë: Planin Strategjik të Institucionit; Strategjinë e Komunikimit (procesi të drejtohet nga Koordinatori për Marrëdhëniet me Mediat); Strategjinë e Burimeve Njerëzore dhe Planin e Trajnimit të punonjësve sipas kategorive; Strategjinë e TIK dhe Sigurisë Kibernetike. Këto të shoqërohen me plane vjetore veprimi;
7. Të hartojë një Plan vlerësimi për Integritetin që të përmbajë masa konkrete antikorrupsion, masa mbi etikën dhe sjelljen e punonjësve të SPAK. Plani mund të qëndrojë i veçantë apo të integrohet në planin e veprimit të Strategjisë së Burimeve Njerëzore;
8. Të identifikojë gjetjet dhe rekomandimet e raporteve të organizatave ndërkombëtare në lidhje me luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe të adresohen ato në përputhje me ligjin dhe praktikat e mirëpranuara ndërkombëtare;
9. Të vijojë me nënshkrimin e marrëveshjeve teknike të bashkëpunimit me agjencitë ligjzbatuese rajonale dhe ndërkombëtare si dhe shteteve të tjera që SPAK e shikon të nevojshme në funksion të efektivitetit të hetimeve për veprat penale që lidhen me kompetencat lëndore të SPAK;
10. Të uniformizojë standardet e hetimit dhe ndjekjes penale, në drejtim të respektimit të të drejtave të njeriut, barazisë para ligjit dhe parimit të proporcionalitetit.

Miraturar në \_\_\_\_\_